


Taksat e Mjedisit në Shqipëri, 2022

Tiranë, më 24 Prill 2024:

Në 2022, të ardhurat nga taksat mjedisore arritën në vlerën e rreth 55.5 miliardë lekë, duke pësuar një rënie prej 4,53 %, krahasuar me vitin 2021.

Nga struktura e të ardhurave të taksave mjedisore për vitin 2022, taksat e energjisë zënë pjesën më të madhe të të ardhurave me 82,45 %, pasuar nga taksat e transportit 12,92 %, taksat e ndotjes me 4,5 % dhe taksat e burimeve natyrore me 0,13 %.

Fig. 1 Pesha që zënë të ardhurat e taksave mjedisore ndaj taksave gjithsej dhe kontributeve shoqërore dhe PBB-së %



Burimi i të dhënave: Ministria e Financës dhe Ekonomisë, përpunim i INSTAT

Tab. 1 Të ardhurat nga taksat mjedisore sipas llojeve (milionë lekë)

	2021	2022
Taksat e Energjisë	49.166	45.734
Taksat e Transportit	6.131	7.166
Taksat e Ndotjes	2.734	2.495
Taksat e Burimeve Natyrore	67	71
Gjithsej	58.099	55.466

Burimi i të dhënave: Ministria e Financës dhe Ekonomisë, përpunim i INSTAT

Gjatë vitit 2022, të ardhurat nga taksat e transportit kanë rritje prej 16,88 %të, ndërkohë që të ardhurat nga taksat e burimeve natyrore kanë pësuar rritje me 5,67 %. Gjatë së njëjtës periudhë, të ardhurat nga taksat e ndotjes gjithashtu kanë pësuar rënie me 8,76 %, ndërsa ardhurat nga taksat e energjisë kanë pësuar rënie prej 6,98 % (Tab. 2).

Tab. 2 Rritja vjetore dhe struktura e të ardhurave nga taksat mjedisore sipas llojeve

	Rritja vjetore (%)		Struktura (%)	
	2021	2022	2021	2022
Taksat e Energjisë	26,90	-6,98	84,62	82,45
Taksat e transportit	12,38	16,88	10,55	12,92
Taksat e Ndotjes	13,29	-8,76	4,71	4,50
Taksat e Burimeve Natyrore	25,02	5,67	0,12	0,13

Burimi i të dhënave: Ministria e Financës dhe Ekonomisë, përpunim i INSTAT

Në 2022, pesha e të ardhurave nga taksat mjedisore ndaj Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB) është 2,59 %, duke pësuar një rënie me 0,54 pikë përqindje, krahasuar me vitin 2021.

Të ardhurat nga taksat mjedisore, në vitin 2022, përbëjnë 10,25 % të të ardhurave tatimore gjithsej dhe kontributeve shoqërore duke pësuar një rënie me 1,97 pikë përqindje, krahasuar me 2021 (Tab. 3).

Tab. 3 Të ardhurat tatimore mjedisore (%)

	2021	2022*
Pesha që zënë të ardhurat e taksave mjedisore ndaj Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB)	3,13	2,59
Pesha që zënë të ardhurat e taksave mjedisore ndaj taksave gjithsej dhe kontributeve shoqërore	12,22	10,25

2022* Referuar vlerësimeve paraprake të PBB –së

Burimi i të dhënave: Ministria e Financës dhe Ekonomisë, përpunim i INSTAT

Metodologjia

Llogaritë e taksave të lidhura me mjedisin

Taksat mjedisore konsiderohen si një instrument ekonomik për të kontrolluar ndotjen dhe menaxhimin e burimeve natyrore dhe ato janë konceptuar për të ndikuar në sjelljen e bizneseve, prodhuesve dhe konsumatoreve. Taksat mjedisore janë modul i llogarive ekonomike në mjedis, pjesë e sistemit të Llogarive Kombëtare.

TVSH dhe taksat e tjera nuk përfaqësojnë një taksë me ndikim direkt parandalues ose frenues të produkteve që dëmtojnë mjedisin, si dhe nuk përdoret në forme ekskluzive për mbrojtjen e mjedisit. Si rezultat këto taksa janë të përjashtuara nga këto vlerësime.

Lista kombëtare e taksave paraqet pikënisje për vlerësimin e të ardhurave nga taksat mjedisore. Metodologjia e përdorur për llogaritjen e tyre është bërë në përputhje me Rregulloren (BE) Nr 691/2011 dhe udhëzimet e Eurostat: "Taksat mjedisore, një udhëzues statistikor". Këto të dhëna janë të harmonizuara me Sistemin Evropian të Llogarive Ekonomike (ESA 2010).

Të dhënat e taksave mjedisore janë siguruar nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë. Të dhënat e taksave mjedisore janë subjekt rishikimi.

Për më shumë referohu: http://instat.gov.al/media/2829/politika_e_revizionimit.pdf

Përkufizime

Më poshtë paraqiten përkufizimet e katër grupeve kryesore të taksave të mjedisit:

1. Taksat e energjisë

Taksat e energjisë (duke përfshirë karburantin e makinave) përfshijnë taksat mbi prodhimet e energjisë në vend, si dhe prodhimet e energjisë që përdoren edhe për qëllime të transportit. Këtu përfshihen edhe tatimet mbi bio-karburantet dhe format e tjera të energjisë nga burimet e rinovueshme, si dhe taksat mbi rezervat e produkteve të energjisë.

2. Taksat e Transportit

Taksat e transportit (me përjashtim karburantin e makinave) i referohen kryesisht taksave të lidhura me pronësinë dhe përdorimin e automjeteve. Këto taksa përfshijnë edhe taksat mbi mjetet e tjera të transportit (si avionët, anijet dhe trenat, etj) dhe shërbimet e tyre.

3. Taksat e Ndotjes

Taksat e ndotjes përfshijnë emetimet e matura në ajër dhe shkarkimet në ujë, menaxhim të mbetjeve të ngurta dhe zhurmës etj. Përfshihen këtu tatimi mbi emetimin e CO₂, i cili mbulohet nga kategoria taksave të energjisë.

4. Taksat e Burimeve Natyrore

Taksat e burimeve natyrore përfshijnë taksat për nxjerrjen apo shfrytëzimin e burimeve natyrore (ujë, pyje, kafshë të egra, etj).